



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:154259
Datë: 21.03.2025
Numri i dokumentit: 07023176

Ac.nr.7287/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Naim Mehulli, anëtar të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Xhennet Shantir, në çështjen juridike kontestimore të paditësve E.D, A.Z, D.V dhe A.V, që të gjithë nga Rahoveci, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Dardan Morina, avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Bilbil Oruçi, avokat nga Rahoveci, me objekt kontesti kompensimi në emër të diferencës në pagë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.*/2021, të datës 23.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.03.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.*/2021, të datës 23.06.2022 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.*/2021, të datës 23.06.2022, ka vendosur si në vijim: *“APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësve E.D, A.Z, D.V dhe A.V i, si dhe DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve t’u paguaj kompensim në emër të diferencës ne pagë, për secilin paditës, si vijon: Paditësit E.D, për periudhën kohore,18.04.2017 deri 31.12.2020, t’ia paguaj në emër të*

kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 2,405.92 € (shpjegim: paga bazë 421.00€ x 27% i pagës bazë (113.00€ - 58.32 diferencë e paguar në pagë = 54.68€) x 44 muaj gjithsej 44x 54.68 = 2,405.92€), - Paditësit A.Z, për periudhën kohore,18.04.2017 deri 31.12.2020, t'ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 2,405.92 € (shpjegim: paga bazë 421.00€ x 27% i pagës bazë (113.00€ - 58.32 diferencë e paguar në pagë = 54.68€) x 44 muaj gjithsej 44x 54.68 = 2,405.92€), -Paditëses D.V për periudhën kohore,18.04.2017 deri 31.12.2020, t'ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 3,917.32 € (shpjegim: paga bazë 421.00€ x 27% i pagës bazë (113.00€ - 41.04 diferencë e paguar në pagë = 71.96€) x 44 muaj gjithsej 44x 71.96 = 3,166.24€), - A.V, për periudhën kohore,18.04.2017 deri 31.12.2020, t'ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 958.48 € (shpjegim: paga bazë 421.00€ x 19% i pagës bazë (79.99€ - 58.32 diferencë e paguar në pagë = 26.67€) x 44 muaj gjithsej 44x 26.67 = 953.48€), e në shumë e përgjithshme për të gjithë paditësit prej 9,687.64€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë nga data (08.06.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, SI ME BAZË. DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 1,737.00 € me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm”.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë e paditura nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, duke e atakuar të njëjtin, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të aprovohet si e bazuar, në atë mënyrë që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëseve apo të prishet në tërësi aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesën e të paditurës, kanë paraqitur paditësit nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim për Gjykatën e Apelit që të refuzohet ankesa si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditëset E.D dhe A.Z, që të dyja nga Rahoveci, nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 12.07.2021 në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi kundër të paditurës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës. Me parashtrësën e datës 10.06.2022, përfaqësuesi i autorizuar i paditësve ka bërë zgjerimin e padisë dhe kërkesëpadisë në aspektin subjektiv dhe objektiv, duke i përfshirë si paditës edhe D.V dhe A.V, duke kërkuar nga gjykata që të aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, ashtu që të obligohet e paditura që paditëses E.D për periudhën kohore 18.04.2017 deri 31.12.2020, t'ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 2,405.92 €, paditëses A.Z për periudhën kohore 18.04.2017 deri 31.12.2020, t'ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 2,405.92 €, paditëses D.V për

periudhën kohore 18.04.2017 deri 31.12.2020, t'ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 3,917.32 €, dhe paditësit A.V për periudhën kohore 18.04.2017 deri 31.12.2020, t'ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 958.48 €, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % që nga dita e paraqitjes së padisë 08.06.2022 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, duke i kërkuar edhe shpenzimet procedurale.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë, pas plotësimit të kushteve procedurale ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.*/2021, të datës 23.06.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas analizimit dhe vlerësimit të provave të administruara dhe vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, ngase nuk ishte kontestuese fakti se paditësit kanë qenë të sistemuar në punët dhe detyrat e punës në SH.F.M.U “I.B” në Rahovec për periudhën kohore të kërkuar sipas padisë. Duke shtuar se me shikimin në diplomën e shkollimit për secilin paditës veç e veç u vërtetua se të njëjtit janë të kualifikuar me fakultet, ndërsa në bazë të licencave të bashkangjitura në shkresat e lëndës u vërtetua se të njëjtit janë të licencuar nga MASHT-i. Po ashtu në bazë të vërtetimeve të lëshuara nga SH.F.M.U “I.B” u vërtetua se për periudhën 18.04.2017 e deri me datë 31.12.2020, secili paditës veç e veç i ka nga 44 muaj pune, ndërsa me shikimin në listën e pagave të datës 31.12.2020, u vërtetua se lartësia e pagës mesatare të paditësve është në shumë prej 421.00 €. Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim për themelësinë e kërkesëpadisë së paditësve, pasi që sipas dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, pika 1.3 dhe pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017, është paraparë se: *“Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: pika 1.3 e nenit 7: Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katërvjeçar, 27 % e pagës bazë, pika 1.2 e nenit 7: Mësimdhënës me Shkollë të lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë”*, andaj mbi bazën e të lartcekurave ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar.

Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 7 paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017. Vendimin mbi kamatën ligjore, gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimin të ankimuar si të rregullt dhe të bazuar në ligj nuk e përkrah Gjykata e Apelit, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) dhe neni 182 paragrafi 1 lidhur me nenin 160 paragrafi 2 dhe 4 të LPK-së. Gjendja faktike po ashtu del të mos jetë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ku për rrjedhojë ka pasur edhe aplikimin e gabuar të

së drejtës materiale për të cilën Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 194 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, është i bazuar pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) të LPK-së dhe neni 182 paragrafi 1, lidhur me nenin 160 paragrafi 2 dhe 4 të LPK-së, ngase aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato arsye të cilat janë dhënë janë të mangëta dhe të paqarta. Në këtë rast gjykata është fokusuar në përshkrimin e pretendimeve dhe deklarimeve të palëve dhe në përshkrimin e provave të administruara, pa dhënë analizë për faktet e vërtetuara, për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për vlerën provuese të provave të administruara dhe për kualifikimin e fakteve respektivisht për përfundimin e gjykatës.

Pra sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë nuk i ka sqaruar faktet vendimtare si dhe nuk ka dhënë fare arsyetim se mbi bazën e cilave prova ka vlerësuar bazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditëses. Po ashtu arsyet e dhëna nuk janë në përputhje të plotë me dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, pra mungon harmonia logjike dhe juridike e dispozitivit me arsyetimin, ngase në arsyetimin e dhënë gjykata e shkallës së parë decidivisht theksohet se: *“...për çka vendosi që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditësve t’ia paguaj pagat në emër të udhëtimit dhe ushqimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”*, ndërsa në dispozitiv të aktgjykimit e ka detyruar të paditurën që paditësve t’ua paguaj shumat në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë, po ashtu kundërthëniet lidhur me përcaktimin e saktë të objektit të kontestit ndërliken edhe me hyrjen e aktgjykimit të ankimuar, në të cilën si objekt kontesti figuron kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, çka e bëjnë aktgjykimin e ankimuar kontradiktor me vetveten.

Po ashtu edhe gjendja faktike në këtë procedurë nuk del të jetë vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë në procedurën e provave ka administruar edhe ato prova të cilat nuk gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht ka administruar listën e pagave për secilin paditës veç e veç, nëpërmjet të cilës e ka vërtetuar lartësinë e pagës mesatare të paditësve, por Gjykatës së Apelit pas shikimit në shkresat e lëndës i ka rezultuar se lista e pagave nuk del të jetë e bashkangjitur nga ana e paditësve, as padisë, por as parashtrësës së datës 10.06.2022, me të cilën është zgjeruar kërkesëpadia e paditësve në aspektin objektiv dhe subjektiv, edhe pse në këtë parashtrësë përfaqësuesi i autorizuar i paditësve ka propozuar që të provohet si provë lista e pagave e datës 31.12.2020, për secilin paditës veç e veç, por që kolegjit të Gjykatës së Apelit nuk i rezulton se e njehta është bashkangjitur si provë shkresave të lëndës. Në këtë drejtim, arsyetimi i dhënë nga gjykata e shkallës së parë nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm për faktin se për një qëndrim të tillë gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme, duke mos sqaruar se cilat janë faktet vendimtare lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë së paditësve. Mbi këtë bazë del se edhe gjendja faktike në këtë procedurë nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, gjykata ankimore vlerëson se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë edhe në shkelje lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, nga shkaku se e drejta materiale mund të zbatohet drejtë vetëm në rastin kur gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, e që i referohen shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182 paragrafi 2 pika n) dhe neni 182 paragrafi 1, lidhur me nenin 160 paragrafi 2 dhe 4 të LPK-së, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, për arsye se në shkresat e lëndës mungon lista e pagave mbi bazën e të cilës gjykata ankimore do të mund të vlerësonte lartësinë e kompensimit në emër të diferencës së pagës, andaj aktgjykimi i atakuar është dashur që të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Në riprocedurë gjykata e shkallës së parë, në kuptim të gjetjeve dhe lëshimeve të konstatuara nga gjykata ankimore, udhëzohet që të vërtetojë gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë duke vërtetuar saktësisht se kur kërkesa e padisë së paditësve është bërë e arritshme, pastaj me interpretim të drejtë të dispozitës së nenit 87 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës të vlerësojë nëse kërkesa e padisë së paditësve është parashkruar apo jo (pretendim i ngritur nga e paditura gjatë procedimit të çështjes), pastaj nëse gjykata e shkallës së parë gjen se kërkesa e paditësve nuk është parashkruar qoftë në tërësi apo pjesërisht, të nxjerrë dhe administrojë si provë listën e pagave për secilin paditës veç e veç, në mënyrë që të vërtetohet saktë lartësia e pagës mesatare të tyre si dhe fakti nëse paditësve u është paguar diferenca në pagë nga ana e të paditurës në emër të kualifikimit që e kanë. Ku pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë duke zbatuar dispozitat ligjore të së drejtës materiale do të ketë mundësi të marrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në fund udhëzohet gjykata e shkallës së parë që me rastin e përpilimit të aktgjykimit, t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozitat e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, aktgjykimin e ankimuar e ka prishur edhe në pjesën lidhur me shpenzimet e procedurës të njohura paditësve, pa u lëshuar fare në ligjshmërinë e kësaj pjese të aktgjykimit të ankimuar, për faktin se kjo lëndë kontestimore u dashtë që të priset dhe gjykatës së shkallës së parë t'i kthehet në rigjykim, me çka pranë asaj gjykate në procedurën e rigjykimit do të krijohen edhe shpenzime tjera procedurale, për të cilat gjykata e shkallës së parë duhet të vendos me rastin e marrjes së aktgjykimit përfundimtar, duke pasur parasysh suksesin e palëve në procedurë dhe dhënies shkas krijimit të shpenzimeve procedurale.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në mbështetje të nenit 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) të LPKsë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7287/2022, me datë 20.03.2025.

Bashkëpunëtorja profesionale
Xhennet Shantir

Kryetarja e kolegjit,
Halide Reka, d.v.

Numri i lëndës: 2021:154259
Datë: 21.03.2025
Numri i dokumentit: 07023176